There are no translations available.

Në kuadrin e zhvillimit te Konferencave te Rretheve me date 05.07.2014 u mblodh Konferenca Zgjedhore e Rrethit Kruje me pjesemarrjen e 49 delegateve qe perfaqesojne 7 seksione te Sindikatave te Rrethit, me nje anetaresi te pergjithshme prej 1470 anetaresh. Në Konference moren pjese te deleguarit e Keshillit Kombëtar të BSPSH-së Presidenti i saj z. Gëzim Kalaja, z. Sami Kariqi Zv/President i BSPSH, si dhe monitoruesi i konferencave zgjedhore Sekretari Organizativ z. Koço Jani. Raporti ne emer te Keshillit Sindikal te Rrethit Kruje u mbajt nga Kryetar i ketij Keshilli z. Engjell Çollaku, i cili paraqiti aktivitetin 5- vjeçar te anetaresise sindikale te Rrethit dhe si probleme te rendesishme, çeshtjet e zbatimit ne vija te pergjithshme te vendimeve te Forumeve Qendrore te BSPSH , te cilat kane te bejne me mbrojtjen e interesave social - ekonomike te punonjesve, çeshtjet e marredhenieve te mira dhe bashkepunimit te ndersjellte me punedhenesit e nderrmarrjeve, me Zyrat Rajonale te Punes, te konkretizuara me lidhjen e nente kontratave kolektive, sipas profesioneve te ndryshme sindikale.

Raporti trajtoi problemet e organizmit dhe te mbeshtetjes konkrete te protestes se punonjesve te fabrikave te Çimentos ndaj masave shtrenguese – bllokuese te Ministrise se Tregetise se Kosoves, siç ishte rasti i ngritjes se tarifes doganore te çimentos shqiptare ne 35% , e cila demtonte rende interesat e punonjesve dhe influenconte negativisht si ne uljen e pagave dhe ne ate te largimeve masive nga puna. Rreth raportit pati edhe diskutime nga delegatet te cilet vleresuan ne pergjithesi aktivitetin e Keshillit Sindikal te Rrethit, por kerkuan nga kjo strukture gjalleri ne organizim sidomos ne çeshtjet e mbrojtjes se vendeve te punes, si nga punedhenesi publik ashtu edhe nga ai privat. Konferencen e pershendeti Presidenti i BSPSH, i cili ne fjalen e tij i kushtoi rendesi te madhe gjendjes reale te punonjesve ne kuadrin e krizes boterore dhe masave shtrenguese te programit qeveritar te kushtezuar nga FMN-ja, te cilat do te ndikonin ne uljen e nivelit te standartit te jeteses, sidomos me vendosjen e taksave te reja dhe ngritjen e çmimit te energjise elektrike. Midis te tjerave Presidenti i BSPSH zoti Kalaja i njohu pjesemarresit e Konferences me politikat e qeverise per zbatimin e reformes ne fushen e pensioneve dhe me qendrimet e BSPSH ndaj projekt-ligjit te paraqitur, ku BSPSH –ja eshte shprehur qarte dhe me argument per mosngritjen e moshes se daljes ne pension, per grate mbi 63 vjeç dhe per burrat mbi 65 vjeç, si dhe kerkesen per ndryshimin e formules se llogaritjes se pensionit duke kerkuar ruajtjen e te drejtave te perfitimit te pensioneve sipas ligjit aktual ekzistues. Konferenca Zgjedhore ne fazen e dyte kaloi ne procedurat e votimit per zgjedhjen e drejtuesit te Keshillit Sindikal te Rrethit si dhe te deklarimit te votave me mandate perfaqesimi per kandidatin per president te BSPSH, te cilat u monitoruan nga Sekretari Organizativ i BSPSH. Ne fund Komisioni i Votimit te Konferences pas verifikimit te votave shpalli z. Engjell Çollaku, kryetar te BSP Kruje.


KONFERENCA E VI-të e B.S.P
DEGA KRUJE



